



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KESHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

Nr. 09, dt. 21.09.2018

MBI MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2019-2021 PËR KËSHILLIN E QARKUT TË RISHIKUAR

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, të Ligjit Nr.9936, dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 68/2017 “Per financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhezimit nr. 23 dt. 22.11.2016 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, UMF Nr. nr. 6/1 dt. 28.02.2018 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”, UMFE nr. 23 dt. 30.07.2018 “Per procedurat standarte te përgatitjes se Programit Buxhetor afatmesem te vetëqeverisjes vendore”, si dhe rekomandimet e Ministrise te Financave dhe Ekonomise mbi analizen e programit buxhetor paraprak, derguar me shkrese nr. 11714 date 19/06/2018, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

VENDOSI

1. Të miratoje Programin Buxhetor Afatmesëm 2019-2021 të rishikuar për Këshillin e Qarkut Korçë të përgatitur sipas Instrumentit të Planifikimit Financiar.
2. Të miratojë Relacionin shpjegues për procesin e përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021 për Këshillin e Qarkut Korçë.
3. Ngarkohet Drejtorja e financës, zhvillimit ekonomik dhe shërbimeve të dërgojë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomise dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021 të rishikuar.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Këshillit të Qarkut

Ana VERUSHI

